



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 12.2 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2017 për Angazhimin e Ekspertëve të Jashtëm, Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës, me datën 28 shkurt 2020 bënë:

RI SHPALLJE PUBLIKE

I. Për angazhimin e një (1) eksperti të jashtëm, për kryerjen e detyrave të caktuara në fushën e infrastrukturës rrugore në mbështetje të projektit të auditimit të performancës “Ndërtimi i rrugëve rajonale dhe lokale”.

II. Kandidatët që shprehin interesim për angazhim duhet t’i plotësojnë këto kritere:

1. Diplomë universitare në lëminë e ndërtimtarisë, me përparësi drejtimi i inxhinierisë së infrastrukturës rrugore;
2. Së paku 5 (pesë) vite përvojë pune, në fushën përkatëse pas diplomimit;
3. Të ketë dëshmi se ka **hartuar/menaxhuar** së paku 3 projekte nga lëmia e kërkuar (hartimi i projekteve për: ndërtimin e rrugëve, urave dhe objekteve tjera përcjellëse për rrugët-preferohet përvoja në rrugë rajonale dhe lokale);
4. Të ketë gatishmëri të punoj në ekip dhe në mënyrë të pavarur.

III. Kandidatët duhet t’i dorëzojnë këto dokumente:

1. Biografi (CV); 2. Kopjen e letërnjoftimit; 3. Dëshminë për studimet universitare; 4. Dëshmitë mbi përvojën e punës në fushën përkatëse për periudhën e kërkuar, kopjet e trajnimeve relevante të kryera (nëse ka); dhe 5. Referencat për punët e mëparshme në lëminë e hartimit/menaxhimit të projekteve apo informatat tjera shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatin që aplikon.

IV. Përzgjedhja e kandidatëve

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas procedurës së përcaktuar me Udhëzimin e Administrativ Nr. 02/2017 për Angazhimin e Ekspertëve të Jashtëm.

Angazhimi në cilësinë e ekspertit nuk nënkupton themelimin e marrëdhënies së punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit. Eksperti i përzgjedhur do të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës për një periudhë të caktuar kohore prej **dymbëdhjetë (12) ditë pune**. Marrëveshja lidhet sipas dispozitave të aplikueshme të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Angazhimi i ekspertit bëhet në bazë ditore. Për punën e kryer bëhet kompensimi në vlerën e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2017 për Angazhimin e Ekspertëve të Jashtëm.

Eksperti i angazhuar duhet të respektojë standardet e zbatueshme të auditimit të njohura ndërkombëtarisht, Kodin e Etikes dhe rregullat tjera të përcaktuara me aktet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Termat e referencës së bashku me qëllimin e angazhimit si dhe përshkrimin e detyrave të punës mund të merren nga faqja e internetit të Zyres Kombëtare e Auditimit, në <http://www.zka-rks.org/>

V. Dorëzimi i dokumenteve

Dorëzimi i dokumenteve bëhet në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, në adresën: **Prishtinë, rruga Ahmet Krasniqi nr. 210 ose përmes postës elektronike: rekrutimi@oagks.org**

Dokumentacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim. Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara, pa dëshmi).

Mundësia për aplikim mbetet e hapur **tetë (8) ditë kalendarike** nga dita e shpalljes, respektivisht deri me datën 07 mars 2020, në ora 16:00.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Divizionin për Burime Njerëzore të ZKA-së, në numrin e tel: 038 606-004 lok. 1005, çdo ditë pune prej orës 08:00-16:00.